



RAPORT VJETOR I VITIT 2020 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2020, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka planifikuar dhe miratuar në total konsultimin e 8 (tetë) projektakteve, 4 (katër) projektligje dhe 2(dy) projektvendime të Këshillit të Ministrave.

Gjatë vitit 2020, MTM ka realizuar 100% planin e saj të konsultimit. Numri i përgjithshëm i projekt-akteve tëplanifikuara përkonsultim gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2020 është 5 (pesë) nga 8 (tetë) të planifikuara në përgjithësi për konsultim gjatë vitit 2020 dhe ka realizuar procesin e konsultimit publik për të pestë këto projekt-akte. Nga këto janë (dy) projektligje dhe 2(dy) projektvendime. Në gjashtëmujorin e dytë janë konsultuar 2 (dy) projektligje.

Nga monitorimi i platformës së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) vihet re se për këto projektaktet ka patur interes nga publiku, por nuk ka patur komente. Numri mesatar i vizitorëve për projektaktet e publikuara në regjistrim për vitin 2020 ka qenë 807 komente, me numrin mw tw lartw tw arriur pwr projektligjin “Pwr aktivitetet e turizmit detar”. Situata e krijuar nga pandemia e COVID-19 ka ndikuar negativisht në pjesëmarrjen aktive të publikut në dhënien e kontributit për përmirësimin e projektligjeve. Ajo që identifikohet nga procesi i konsultimit i realizuar, edhe pse vihet re një përmirësim i këtij procesi gjatë kësaj periudhe, është nevoja për informim më të mirë të këtij të publik dhe pjesëmarrje më aktive e tij.

2. Analiza e konsultimeve të kryera gjatë vitit 2020

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Numri i përgjithshëm i akteve, të cilat i janë nënshtruar konsultimit publik gjatë vitit 2020 nga Ministria e Turizmit dhe është 8 (tetë) projektakte, si vijon:

1. VKM “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035”;
2. VKM “Për disa ndryshime në vendimin nr.641, datë 01.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”;
3. Projektligj “Për aktivitetet e turizmit detar”;
4. Projektligj “Për disa shtesa në ligjin nr.8743, datë 22.02.2001, Për pronat e paluajtëshme të shtetit, i ndryshuar”;
5. Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, Për mbrojtjen e biodiversitetit, të ndryshuar”;
6. Projektvendim “Mbi rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër”;
7. Projektvendim “Për miratimin e rregullave të nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbest”;
8. Projektligj “Ligji për ndryshimet klimatike”.



Anjë nga projektaktet e sipërpërmendur nuk janë të përfshira në PPAP. PPAP për vitin 2020 ka parashikuar miratimin e 12 (dymbëdhjetë) projektakteve.

Përzgjedhja e tyre është bërë në përputhje ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projektdokumentet strategjike kombëtare dhe vendore, dhe për pasojë nga ana jonë konsultimi publik është parashikuar të realizohet vetëm për projektaktet që kanë detyrimin për t’iu nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1 të ligjit të lartpërmendur. Ndërsa në nenin 4 të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik“ është parashikuar lista e projektakteve që nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, siç janë çështjet e sigurisë kombëtare që përbëjnë sekret shtetëror, marrëveshjet ndërkombëtare, aktet normative të KM me fuqinë e ligjit, emergjenca civile dhe çështje të tjera të parashikuara me ligj.

2.1.1. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Tetë akte i janë nënshtruar konsultimit publik.

2.1.2. Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse do të kishte të tilla)

VKM "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.967, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave ‘Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të menaxhimit të integruar të mbetjeve”, nuk ka qenë objekt i konsultimit publik sepse nuk parashikohet ndikim i drejtëpërdrejtë në publik dhe/ose palët e interesit.

2.1.3. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, rregullore ministrore, etj.)?

Nga 8 (tetë) projektakte të konsultuara gjatë vitit 2020, 4 (katër) janë projektligje, 2 (dy) projektvendime dhe 2 (dy) VKM.

2.2. Metodat e konsultimit

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishin 3(tre):

1. konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik,
2. tryeza të konsultimit me ekspertë,
3. nëpërmjet faqes zyrtare të Ministrisë duke kontaktuar me adresën e emailit të personave të kontaktit.

2.1.4. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistrin elektronik, postën elektronike, faqet e internetit, takimet publike, komitetet këshilluese, etj.)

- Regjistri elektronik për njoftim dhe konsultim publik – metoda e përdor për aktet e mëposhtme:



- 1) VKM “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035”;
 - 2) VKM “Për disa ndryshime në vendimin nr.641, datë 01.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”;
 - 3) Projektligj “Për aktivitetet e turizmit detar”;
 - 4) Projektligj “Për disa shtesa në ligjin nr.8743, datë 22.02.2001, Për pronat e paluajtëshme të shtetit, i ndryshuar”;
 - 5) Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 9587, date 20.7.2006, Për mbrojtjen e biodiversitetit, të ndryshuar”;
 - 6) Projektvendim “Mbi rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër”;
 - 7) Projektvendim “Për miratimin e rregullave të nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti”;
 - 8) Projektligj “Ligji per ndryshimet klimatike”.
- E-mail – komunikimi, dhënia e komenteve dhe sugjerimeve nëpërmjet MTM, ministrive të linjës dhe palëve të tjera të interesit është përdorur për aktet e mëposhtme:
 - 1) VKM “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035”;
 - 2) VKM “Për disa ndryshime në vendimin nr.641, datë 01.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”;
 - 3) Projektligj “Për aktivitetet e turizmit detar”;
 - 4) Projektligj “Për disa shtesa në ligjin nr.8743, datë 22.02.2001, Për pronat e paluajtëshme të shtetit, i ndryshuar”;
 - 5) Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 9587, date 20.7.2006, Për mbrojtjen e biodiversitetit, të ndryshuar”;
 - 6) Projektvendim “Mbi rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër”;
 - 7) Projektvendim “Për miratimin e rregullave të nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti”;
 - 8) Projektligj “Ligji per ndryshimet klimatike”.
 - Takime publike – është metoda e përdorur për aktet e mëposhtme:
 - 1) VKM “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035”;
 - 2) Projektligj “Për aktivitetet e turizmit detar”;
 - 3) Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 9587, date 20.7.2006, Për mbrojtjen e biodiversitetit, të ndryshuar”;



- 4) Projektvendim “Për miratimin e rregullave të nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti”;
- 5) Projektligj “Ligji për ndryshimet klimatike”.

Pra, 100% e akteve të planifikuara për këtë periudhë u konsultuan nëpërmjet Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe komunikimeve nëpërmjet postës elektronike, ndërsa vetëm 62.5% duke përdorur metodën e takimeve publike me ekspertë, ministri të linjës, OJF dhe palë të tjera të interesit.

2.1.5. *Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e tryezave të konsultimit.

2.1.6. *A organizoi ministria gjithashtu disa konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka realizuar konsultime paraprake për aktet e mëposhtme:

- 1) VKM “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035”;
- 2) VKM “Për disa ndryshime në vendimin nr.641, datë 01.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”;
- 3) Projektligj “Për aktivitetet e turizmit detar”;
- 4) Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, Për mbrojtjen e biodiversitetit, të ndryshuar”;

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.1.7. *Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditët e kërkuara? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes?*

Konsultimi në Regjistrimin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për të gjitha aktet e planifikuara gjatë vitit 2020 u realizua në përputhje me ligjin nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij.

Pesë nga tetë konsultimet patën një kohëzgjatje prej 20 ditësh nga data e publikimit, dy konsultime kanë zgjatur 40 ditë pune dhe 1 ka qenë i hapur për më shumë se 20 ditë, si më poshtë:

- 1) VKM “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035” - 08.07.2019-30.07.2019 (20 ditë pune).
- 2) VKM “Për disa ndryshime në vendimin nr.641, datë 01.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte” - 20.05.2020-17.06.2020 (20 ditë pune).
- 3) Projektligj “Për aktivitetet e turizmit detar” - 18.02.2020-10.03.2020 (20 ditë pune).



- 4) Projektligj “Për disa shtesa në ligjin nr.8743, datë 22.02.2001, Për pronat e paluajtëshme të shtetit, i ndryshuar” - 25.06.2020-22.07.2020 (20 ditë pune).
- 5) Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 9587, date 20.7.2006, Për mbrojtjen e biodiversitetit, të ndryshuar” - 18.11.2019-18.01.2020 (40 ditë pune).
- 6) Projektvendim “Mbi rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër” - 07.11.2019 – i hapur.
- 7) Projektvendim “Për miratimin e rregullave të nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti” - 19.11.2019 - 20.12.2019 (20 ditë pune).
- 8) Projektligj “Ligji për ndryshimet klimatike” – 40 ditë pune.

2.1.8. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për këtë periudhë ishte përafërsisht **26 ditë pune**.

2.1.9. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin e kaluar situata nuk ka pasur përmirësime të dukshme të procesit të konsultimit, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik vijon të jetë ende i ulët për akte të caktuara. Akti që përfshijnë ndryshimet klimatike dhe biodiversitetin paraqesin interes më të lartë për publikun. Mosinformimi dhe mungesa e kulturës së përfshirjes në hartimin e politikave publike ka sjellë edhe mungesën e reagimeve mbi aket e publikuara për konsultim. Gjatë vitit 2020 vihet re një interes në rritje i organizatave jofitimprurëse në drejtim të përmirësimit të projektakteve.

Vlerësojmë se gjatë vitit 2020, një faktor që mund të ketë ndikuar në mungesën e reagimeve nga ana e publikut ka qenë dhe situata e krijuar nga pandemia mbarëbotërore shkaktuar nga COVID-19.

2.4. Palët e interesit të përfshira

2.4.1 Sa palë interesi të jashtme morën pjesë në grupet e punës për hartimin e akteve? Sa eksperte ishin në tryeza?

Në konsultimet e zhvilluara gjatë 2020 aktorët pjesëmarrës ishin kryesisht ekspertë të fushës, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të organizatave jofitimprurëse.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individual, OSHC, kompani, etj.)

Për konsultimin e projektakteve për vitin 2020, pjesëmarrësit në tryezat e konsultimit ishin:

- ekspertë individual,
- përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse,
- përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, dhe



- përfaqësues nga institucione publike të pavarura apo institucione të varësisë.

2.4.3 *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të bëra për projekt-akte në vitin e caktuar?*

Gjatë procesit të konsultimit, në varësi të projektaktit morën pjesë ministritë e linjës, institucionet e varësisë së ministrivë, ekspertë, OJQ, onorganizata ndërkombëtare, qytetarë etj.

2.4.4 *Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Pjesa më e madhe e komenteve janë përcjellë kryesisht nga përfaqësues të organizatave jofitimprurëse ku ndër të cilët mund të përmendim INCA, PPNEA, AOS, Qendra EDEN, REC Shqipëri etj.

2.4.5 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara nuk ka ndryshuar shumë. Në Regjistrin Elektronik nuk shihen vizitorë të shumtë dhe rrjedhimisht shumicën e rasteve nuk ka komente për projektaktet e publikuara.

2.5.Rekomandimet dhe komentet e marra

Rekomandimet dhe komentet në numër më të lartë janë marrë në projektligjet “Ligji për ndryshimet klimatike” dhe “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, Për mbrojtjen e biodiversitetit, të ndryshuar”.

2.5.1. *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Rekomandimet dhe komentet në numër më të lartë janë marrë në projektligjin “Ligji për ndryshimet klimatike”, 33 komente dhe për projektvendimin “Për miratimin e rregullave të nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti”, 4 komente.

2.5.2. *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Rezultojnë 37 komentetë mbledhura për 8 aktet e konsultuara gjerësisht me grupet e interesit, prej të cilave:

- 26 janë pranuar plotësisht
- 12 janë refuzuar plotësisht.

2.6.Rezultatet e raporteve të konsultimeve

2.6.1. *Sa raporte konsultimesh publikoi ministria?*

Për vitin 2020 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka publikuar asnjë raport konsultimi.

2.6.2. *Nëse disa nuk u botuan, cilat janë arsyet?*



2.7.Sfidat, rreziqet kryesore dhe mundësitë për të ardhmen

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithëpërshirjen e publikut në këtë proces. Ende shihet një neglizhencë e publikut në angazhimin e tyre në politikatat që janë objekt i konsultimit publik.

Gjatë vitit 2020 ishte sfidë dhe konsultimi online, duke qenë së ishte e vështirë takimi me palët e interesuara.